



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	06
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-1890
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-10-
Data: Datum: Date:	15.03.2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health
Departamenti për Zhvillim Strategjik Shëndetësor / Departman za strateški razvoj
zdravstva / Department of Strategic Health Development

PËR/ZA/TO:	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë		
CC:	Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm		
NGA/OD/FROM:	Ass. Dr. Edmond Haliti, PhDc, FESC, Kryesues i BShS		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	REKOMANDIM për shpalljen e konkursit për shkollim specialistik		
Nr. i zyrës:	Lokacioni:	Data:	15.03.2024
Br. kancelarije:	Kucni:	Datum:	
Room No.:	Extension:	Date:	
PËR AKTIVITET / ZA AKTIVNOST / FOR ACTION			<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM / ZA USVAJANJE / FOR APPROVAL			<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM / ZA POTPIS / FOR SIGNATURE			<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE / ZA KOMENTARE / FOR COMMENTS			<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË / DALI MOZEMO RASPRAVLJATI / MAY ËE DISCUSS			<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ / VASA PAZNJA / YOUR ATTENTION			<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT / KAKOJE RASPRAVLJENO / AS DISCUSSED			<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR / KAKO JE ZATRAZENO / AS REQUESTED			<input type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE / BELESKA I ODGOVOR / NOTE AND RETURN			<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ / ZA VASU INFORMACIJU / FOR YOUR INFORMATION			<input type="checkbox"/>
AFATI / KRAJNI ROK / DEADLINE			

Të nderuar,

Në pajtim me **Ligjin për Shëndetësi Nr. 04/L-125** dhe **Udhëzimin Administrativ mbi shkollimin specialistik Nr.01/2023** (nenet 16, 17, 18), Bordi për Shkollim Specialistik (BShS) në përputhje me kompetencat e tij, pas pranimit të kërkesave nga institucionet e ndryshme shëndetësore, e më tej në bazë të analizës së tyre në raport me kapacitetet mentoriale e infrastruktorore në nivel vendi, i rekomandon Ministrit të Shëndetësisë shpalljen e konkursit për shkollim specialistik për doktorët e mjekësisë (MD), doktorët e stomatologjisë (MS), magjistrat e farmacisë (Mr Ph) dhe në lëmitë e mëposhtme sipas kategorizimit dhe specifikave në vijim:

- I. **Kategoria: lëmitë specialistike PRIORITARE** (profesionistët aplikojnë sipas kushteve dhe kriterëve të konkursit dhe rradhiten sipas pikëve të grumbulluara me sistem zbritës, duke bërë përzgjedhjen e lëmisë dhe institucionit të preferuar pas rangimit, ndërsa pas procesit përzgjedhës, lidhin kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet publike shëndetësore brenda ShSKUK (sipas kërkesave të këtyre të fundit).

Lëmia specialistike	Titulli paraprak	Institucioni	Numri i vendeve	Arsyetimi
Mjekësi Emergjente	MD	ShSKUK	Total 7, sipas shpërndarjes: SP Ferizaj 1, SP Gjakove 1, SP Gjilan 1, SP Peje 1, SP Mitrovice 1 SP Prizren 1 SP Vushtrri 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Anesteziologji me Mjekim Intenziv	MD	ShSKUK	Total 8 sipas shpërndarjes: QKUK 1, SP Ferizaj 1, SP Gjakove 1, SP Gjilan 1, SP Peje 1, SP Mitrovice 1, SP Prizren 1 SP Vushtrri 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Mjekësi Interne	MD	ShSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes:	Ka kërkesa të institucioneve dhe
			QKMP Gjakove 1, SP Gjakove 1, SP Gjilan 1, SP Prizren 1.	ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Nefrologji	MD	ShSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: SP Ferizaj 1, SP Peje 1, SP Gjakove 1 SP Prizren 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Transfuziologji	MD	ShSKUK	Total 5, sipas shpërndarjes: SP Mitrovice 1, SP Peje 1, SP Gjilan 1, SP Gjakove 1, SP Prizren 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Kirurgji e përgjithshme	MD	ShSKUK	Total 5, sipas shpërndarjes: SP Vushtrri 1, SP Gjakove 1, SP Peje 1,	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture

			SP Gjilan 1, SP Mitrovice 1	
Mikrobiologji klinike	MD	ShSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: QKUK-1 SP Pejë -1 ISHP Mitrovice 1, ISHP Gjilan 1.	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore
Epidemiologji	MD	ShSKUK	Total 4, sipas shpërndarjes: ISHP Gjilan 1, ISHP Mitrovice 1, ISHP Pejë 1, ISHP Gjakove 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore
Sëmundje ngjitëse	MD	ShSKUK	Total 3, sipas shpërndarjes: SP Ferizaj 1, SP Gjakove 1, SP Mitrovice 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore
Farmaci Klinike	Mr Ph	ShSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: QKUK 2	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore
Toksikologji kimike	Mr Ph	ShSKUK	Total 2, sipas shpërndarjes: QKUK 2	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore

- II. **Kategoria: lëmitë specialitike për Kujdesin Primar Shëndetësor** (profesionistët aplikojnë sipas kushteve kriterive të konkursit në këtë kategori, rradhiten sipas pikëve të grumbullura me rradhitje zbritëse, por parakusht për këtë kategori është rekomandimi/ letra mbështetëse dhe kontrata paraprake me institucionet e KPSH, sipas kërkesave të tyre dhe zotimit se do të mbështesin shkollimin specialistik, ndërsa pas procesit përzgjedhës lidhin kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet publike shëndetësore të KPSH).

Lëmia specialitike	Titulli paraprak	Institucioni	Numri i vendeve	Arsyetimi
Pediatri	MD	QKMF me maternitet	Total: 5 , sipas shpërndarjes: Lipjan 1 Suhareke 1 Glllogoc 1 Dragash 1 Deçan 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore
Biokimi klinike	MD	QKMF	Total: 9 , sipas shpërndarjes: Prishtina 1 Prizren 1 Peja 2	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukturore

			Gjakova 2 Gjilan 2 Mitrovice 1	
Radiologji	MD	QKMF	Total: 7 , sipas shpërndarjes: Prishtinë 1 Prizren 1 Pejë 1 Suharekë 1 Gjilan 1 Fushë Kosovë 1 Malishevë 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Gjinekologji me obstetrikë	MD	QKMF me maternitet	Total: 4 , sipas shpërndarjes: Gllgovc 2, Dragash 1, Deçan 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Pedodonci	MS	QKMF	Total: 9 , sipas shpërndarjes: Pejë 2 Gjakovë 2 Gjilan 2 Mitrovicë 1 Gllgovc 1 Fushë Kosovë 1	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
Mjekësi Familjare	MD	QKMF	Total: 98 , sipas shpërndarjes: Prishtina 10 Prizren 10 Pejë 12	Ka kërkesa të institucioneve dhe ka kapacitetet mentoriale e infrastrukture
			Gjakovë 12 Gjilan 5 Mitrovicë 4 Klinë 8 Lipjan 9 Novobërd 2 Suharekë 10 Gllgovc 5 Deçan 3 Fushë Kosovë 2 Malishevë 5 Vitia 1 Rahovec 5	

- III. **Kategoria: lëmitë specialistike për Institucionet Publike shëndetësore ose jo-shëndetësore të tjera** që ju nevojiten profesionistët shëndetësor të specializuar sipas lëmive që ata kanë kërkuar (profesionistët aplikojnë sipas kushteve kritereve të konkursit në këtë kategori, rradhiten sipas pikëve të grumbullura me rradhitje zbritëse, por parakusht për këtë kategori është rekomandimi/ letra mbështetëse dhe kontrata paraprake me institucionin përkatës, sipas kërkesave të tyre dhe zotimit se do të mbështesin shkollimin

specialistik, ndërsa pas procesit përzgjedhës lidhin kontratë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionin në fjalë):

Lëmia specialitike	Titulli paraprak	Institucioni	Numri i vendeve	Arsyetimi
Farmacit klinike	Farmacit	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture.

IV. **Kategoria: lëmitë specialitike për profesionistët shëndetësor jashtë territorit të Republikës së Kosovës, bazuar nga kërkesat zyrtare ose marrëveshjet ndërshtetore**

Lëmia specialitike	Titulli paraprak	Institucioni	Numri i vendeve	Arsyetimi
Dermatovenerologji	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
ORL	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Oftalmologji	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Neurologji	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Pediatri	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Mjekësi Interne	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Gjinekologji me obstetrikë	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale

				dhe infrastrukture
Mjekësi Emergjente	MD	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Kirurgji orale	MS	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Ortodonci	MS	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Sëmundje e dhëmbit me endodoncion	MS	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Kirurgji maksillofaciale	MD, MS	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Farmacit Klinike	Mr Ph	Lugina e Preshevës	1	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Mjekësi Interne	MD	Republika e Shqipërisë – komunitat veriore të zonës kufitare	4	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture
Kirurgji orale	MS	Republika e Malit të Zi-komunitat shqiptare	2	Ka kërkesa nga institucioni, ka mjaftueshëm kapacitete mentoriale dhe infrastrukture

Me respekt

Në pajtim me **Ligjin për Shëndetësi Nr 04/L-125** dhe **Udhëzimin Administrativ (UA) për Shkollim specialistik 01/2023, nenet 16, 17 dhe 18**, Bordi për Shkollim Specialistik konform kompetencave të veta, përcakton kushtet dhe dokumentet e nevojshme për aplikim për shkollim specialistik në fushat Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji, Farmaci e Psikologji Klinike, sipas kategorive, lëmive specialistike dhe kërkesave të institucioneve të paraqitura në konkurs, sikurse edhe kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve, si më poshtë vijon:

Kushtet e aplikimit për shkollim specialistik:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare (niveli bachelor dhe master ose studimet e integruara që përfshijnë këto dy nivele) në drejtimet: Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji, Farmaci ose Psikologji Klinike, sipas nenit 18, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të UA për Shkollim specialistik 01/2023;
2. Të kenë licencë pune nga fusha profesionale përkatëse;
3. Aplikantët kanë të drejtë aplikimi në njërin nga drejtimet specialistike të shpallura në këtë konkurs, sipas drejtimeve respektive dhe lëmive specialistike përkatëse të specifikuar në shtojcën 2 të UA për Shkollim specialistik 01/2023.
4. Të ketë aftësi psiko-fizike për zbatimin e shkollimit specialistik, sipas nenit 18, paragrafi 1.6 i UA për Shkollim Specialistik 01/2023;
5. Aplikanti në lëmitë specialistike kirurgjike në ditën e aplikimit duhet të mos ketë më shumë se 40 vjeç, sipas nenit 18, paragrafi 1.7 i UA për Shkollim Specialistik 01/2023;
6. Të jenë anëtar të Odës përkatëse të Profesionistëve Shëndetësor, sipas nenit 18, paragrafi 1.8 i UA për Shkollim Specialistik 01/2023;

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar për shkollim specialistik:

1. Diploma (apo certifikata e nostrifikimit të Diplomës) e studimeve universitare (niveli bachelor dhe master ose studimet e integruara që përfshijnë këto dy nivele) në drejtimet: Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji, Farmaci, Psikologji Klinike;
2. Certifikata e notave me kalkulim të notës mesatare (nëse kjo nuk figuron në Diplomë), ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës duhet vërtetim i barasvlerësimit të notës mesatare në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina";
3. Licenca e punës e profesionistit shëndetësor;
4. Certifikata mjekësore e aftësisë psiko-fizike;
5. Kopja e letërnjoftimit;
6. Ekstrakti i lindjes i Republikës së Kosovës;
7. Vërtetim antarësie nga Odat përkatëse të Profesionistëve Shëndetësor;

8. Vërtetim mbi përvojën e punës në fushën profesionale përkatëse, nëse aplikanti ka përvojë pune (ky nuk është një dokument diskualifikues, por në mungesë të tij konsiderohet se nuk ka përvojë pune);
9. Deklaratë nën betim në lidhje me një specializim paraprak (te filluar ose te përfunduar) e plotësuar dhe e nënshkruar personalisht nga aplikanti (mund të shkarkohet në vegzën konkursit);
10. Rekomandim me shkrim (letër mbështetëse) nga drejtori i institucionit për aplikantët e kategorive II, III sipas këtij konkursi, nga institucioni kerkues dhe I cili rekomandon e zotohet se do t'a mbështesë shkollimin specialistik të tij/saj (ne përmbajtje e këtij rekomandimi/letre mbeshtetese duhet te shenohet decidivisht zotimi per mbeshtetje financiare i bazuar ne nevojat e institucionit);
11. Kontrata aktuale e punës për aplikantët e kategorive II, III sipas këtij konkursi, me institucionin kerkues dhe i cili e rekomandon e zotohet se do t'a mbështesë shkollimin specialistik të tij/saj;
12. Rekomandim me shkrim nga institucioni/ asociacioni/ organizata kërkuese jashtë vendit për kategorinë e IV - të sipas këtij konkursi.

Kriteret e përzgjedhjes së aplikantëve për shkollim specialistik:

Pikët maksimale që aplikanti mund të grumbulloj janë 100, të shpërndara sipas kriterëve:

Pikë POZITIVE

1. Nota mesatare: 40/100 pikë (sipas sistemit 4 x nota mesatare)
2. Koha e pritjes nga diplomimi: 10/100 pikë (sipas sistemit 1 pikë/vit, deri në maksimumin 10 pikë); *përfshihet këtu viti akademik I studimeve 1998/1999 për ish studentët e UPHP.*
3. Përvoja e punës profesionale në fushën përkatëse ku posedon licencën: 10/100 pikë (sipas sistemit 2 pikë/vit, deri në maksimumin 10 pikë);
4. Njohja e gjuhëve të huaja anglisht ose/dhe gjermanisht: 5/100 pikeve, me dëshmi nga institucion kredibil ose Fakulteti i Gjuheve të huaja të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" sipas sistemit 2.5 pikë nëse kandidati dëshmon njohjen e një gjuhe me certifikatë valide te nivelit B ose ekuivalent I tij me maksimumin e mundshëm 5 pikë;
5. Studimet postdiplomike të nivelit doktoratës (PhD/Dr sc) ose Magjistraturës shkencore (Mr sc): 10/100 pikë (sipas sistemit PhD e përfunduar 10 pikë; PhD e regjistruar 3 pikë, Magjistraturë e përfunduar 5, Magjistraturë shkencore e regjistruar 2 pikë);
6. Punimet shkencore: 10/100 pikë (sipas sistemit autor i parë ose korrespondent në punim origjinal/revial/metanalizë të publikuar në revistë me recension ndërkombëtar 5

pikë deri 10 pikë, autor i parë në studim rasti i publikuar në revistë me recension ndërkombëtar 3 pikë, deri në 6 pikë maksimumi; autor i parë ose korrespondent në punim origjinal/revial/metanalizë në revistë vendore ose rajonale me 3 pikë deri në maksimum 6 pikë maksimum, autor i parë në studim rasti në revistë vendore ose rajonale me 2 pikë deri në 6 pikë maksimumi; (përfshihen këtu revistat predatory).

7. Prezentime në konferenca shkencore: 10/100 pikë (sipas sistemit pjesëmarrje aktive në konferencë ndërkombëtare 5 pikë me maksimum 10 pikë, pjesëmarrje aktive në konferenca vendore ose rajonale 3 pikë (prezentim oral ose poster i moderuar, ose autorë i parë në poster jo të moderuar) me maksimum 10 pike.
8. Pjesëmarrje në programe observershipi/internship/fellowship në fushën profesionale jashtë vendit (dëshmuar me certifikatë pjesëmarrjeje): 5/100 pike sipas sistemit me qëndrim 3 muaj e më shumë 5 pikë, më pak se 3 muaj 3 pikë, më pak se 3 javë 1 pikë, me maksimumin e mundshëm 5 pikë.

Pikët NEGATIVE:

1. Vonesat në afatin e diplomimit: -10/100 pikë (sipas sistemit -0.5 pikë/vit vonesë, deri në minimumin -10 pikë); përjashtimisht rasteve të përcaktuara me statutet e IAL, krahas dëshmive perkatëse.
2. Specializimi paraprak: -30/100 pikë (sipas sistemit -30 pikë specializim i përfunduar ose i papërfunduar/pezulluar/ndërprerë (përfshihen këtu ata të cilët e kanë regjistruar specializimin dhe kanë kryer obligimet kontraktuale me Ministrinë e Shëndetësisë apo Institucionin Shëndetësor ose ata të cilët këtë e kanë bërë për arsye shëndetësore të dokumentuara me mendim konziliar).
3. Terheqja pa arsye nga konkursi paraprak pas daljes së rezultateve përfundimtare, në fazën e parapare për lidhjen së kontratës: -10/100 pike.

Vërejtje:

-çdo kandidatë ka të drejtë të përzgjedh një lëmi specialistike ku dëshiron të aplikoj nga lista e specializimeve të ofruara dhe konform profilit profesional (që e specifikon shtojca 2 e UA për shkollim specialistik 01/2023), ndërsa kjo preferencë duhet të korrespondoj me rekomandimin (letrën mbështetëse) nga institucioni përkatës, kur është fjala për kategoritë II, III, IV sipas këtij konkursi;

-për kategorinë II dhe III sipas këtij konkursi përzgjedhja bëhet sipas rradhitjes nga shuma e pikëve të grumbulluara në lëminë specialistike të cilën e ka përzgjedhur aplikanti në momentin e aplikimit, e cila duhet të korrespondoj me institucionin në të cilin aplikanti ka kontratë pune paraprake si dhe më lëminë e rekomanduar (letrën mbështetëse) nga po i njëjti institucion.

-në rastin kur dy e më shumë kandidatë dalin me shumë të pikëve të barabarta, përzgjedhja do të bëhet sipas notës mesatare.

-konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.